



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT

SHPALLJE PËR POZICIONIN PËRGJEGJËS SEKTORI

Në zbatim të Vendimin Nr. 132, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve”, si dhe të Urdhrit të Kryeministrit nr. 94, datë 12.06.2024 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve”.

Përgjegjësi i Sektorit të Monitorimit dhe Mbikëqyrjes, në Drejtorinë e Monitorimit dhe Performancës, në Agjencinë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve

Afati për dorëzimin e dokumenteve 28/06/2024 pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

- Përcaktimi i objektivave dhe detyrave të specialistëve, për monitorimin e veprimtarisë së tyre dhe koordinimin mes tyre;
- Drejtimi veprimtarisë së Sektorit në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me funksionet e objektivat e Drejtorisë.
- Monitorimi i zbatimit dhe performancës së sistemit të menaxhimit të integruar të mbetjeve në nivel vendor dhe rajonal, në bashkëpunim të ngushtë me njësitë qeverisjes vendore, institucionet e administratës publike dhe partnerët ndërkombëtar.
- Monitorimi i zbatimit të programit të qeverisë dhe të masterplanit kombëtar sektorial të menaxhimit të integruar të mbetjeve.
- Monitorimi i zbatimit të udhërrëfyesit (“roadmap”), për kalimin nga ekonomi lineare drejt ekonomisë qarkulluese.

KUSHTET PËR PRANIM DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për pranim si dhe kriteret e veçanta si vijon:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojnë diplomë të ciklit të dytë të studimeve, të nivelit “Master Shkencor” ose të barasvlefshëm me të, në shkenca Shoqërore/Juridike/Mjedisore/Ekonomike;
- Të kenë të pakten 1 (një) vit eksperiencë pune;

- e. Të mos jetë marrë ndaj tij masë disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi;
 - f. Të mos jenë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
 - g. Të mos ketë konflikt interes i në ushtrimin e detyrës;
-
- h. Të ketë njohuri shumë të mira profesionale të çështjeve teknike dhe aftësi për të planifikuar, rishikuar dhe drejtuar punën e stafit nën varësi;
 - i. Të ketë aftësi për të përcaktuar objektivat, vendosur prioritetet dhe respektuar afatet;
 - j. Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi, prezantimi;
 - k. Të ketë aftësi analitike dhe fleksibilitet në pranimin e metodave dhe procedurave të reja
 - l. Të kenë aftësi të mira menaxheriale dhe të procedurave administrative;
 - m. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze;
 - n. Të ketë aftësi për të përcaktuar objektivat, vendosur prioritetet dhe respektuar afatet;
 - o. Të ketë aftësi analitike dhe fleksibilitet në pranimin e metodave dhe procedurave të reja.

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i aplikantit;
- b- Fotokopje të diplomës/diplomave dhe listes se notave (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore (në momentin e fillimit të marrëdhënieve të punës);
- f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g. Dy referenca nga punëdhënës apo bashkëpunëtorë të mëparshëm;
- gj. Certifikata për trajnime në lidhje me pozicionin për të cilin konkurojnë;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka mase disiplinore në vitin e fundit;
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton dokumentet e përmendura në jetëshkrimin tuaj; Dokumentat duhet të dorëzohen drejtpërsëdrejti në MTM brenda datës 28/06/2024.

REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT TE DOKUMENTACIONIT

Komisioni ad-Hoc do të shpallë në faqen e internetit të MTM, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për intervistën e strukturuar me gojë, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht (nëpërmjet adresës së e-mail), për shkaqet e moskualifikimit.

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim për njojuritë mbi dokumentet e listuara më poshtë:

- Njojuritë mbi Ligjin nr. 10431, datë 9.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, i ndryshuar;
- Njojuritë mbi Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, i ndryshuar;

- Njohuri mbi VKM-në nr. 418, datë 27.05.2020 “Për miratimin e dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2020-2035”;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë";
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”;
- Njohuri mbi Vendimin Nr. 132, datë 6.03.2024, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve”.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me organizimin dhe drejtimin e veprimitarës drejtuese;
- b- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE DHE KOMUNIKIMI

Kandidatët do të vlerësohen me pikë si më poshtë:

- a- Intervistën e strukturuar me gojë, deri në 60 pikë;
- b- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 40 pikë.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e Burimeve Njerëzore në MTM do të njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail) dhe do të shpallë fituesit në faqen zyrtare të ministrisë.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentacioneve të cituara më sipër, duhet të bëhet brenda datës 28.06.2024 në protokollin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;

Zhvillimi i intervistës do të zhvillohet në datën 8.07.2024, në ambientet e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;